

**UDHËZIM**  
**Nr. 9, datë 4.7.2012**

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 19.1.2012 “PËR PROCEDURAT E NJEHSIMIT TË DËFTESAVE/DIPLOMAVE TË SHKOLLAVE TË MESME TË SHTETASVE SHQIPTARË DHE TË HUAJ QË KANË KRYER ARSIMIN E MESËM JASHTË SHTETIT”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të nenit 13 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimeve në shkollat e larta publike” të ndryshuar

**UDHËZOJ:**

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 19.1.2012 “Për procedurat e njehsimit të dëftesave/diplomave të shkollave të mesme të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit” pika 4 gjerat “a”, “b” dhe “c” të ndryshojnë si më poshtë:

“4. Periudha kohore e njehsimit të dëftesave/diplomave të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që kanë fituar diplomë të shkollës së mesme jashtë shtetit, të jetë:

a) 15 mars - 15 prill dhe 15 gusht - 25 gusht: për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kërkojnë të vazhdojnë studimet në programet e studimit me kohë të plotë dhe me kohë të shkurtuar në IAL-të publike, në programet e studimit në IAL-të private.

b) shtator - dhjetor: për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kërkojnë të vazhdojnë studimet në programet e studimit në IAL-të private.

c) në çdo kohë: për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që nuk kërkojnë të vazhdojnë studimet universitare në Shqipëri.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe Komisioni i Posaçëm.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Myqerem Tafaj**